



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 24

Tiranë – E hënë, 24 qershor 2019

PËRMBAJTJA

Faqe

Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1847, datë 20.6.2019	Për botimin e vendimeve për dënim administrativ, ndaj subjekteve “Besmir Bucpapaj (Club Tuneli)”, “Enkein-Oil” dhe “Tirana Themel”.....	3
---	---	---



KËRKESË
Nr. 1847, datë 20.6.2019

**PËR BOTIMIN E VENDIMEVE PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTEVE “BESMIR BUCPAPAJ
(CLUB TUNELI)”, “ENKEIN-OIL” DHE
“TIRANA THEMEL”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “BESMIR BUCPAPAJ (CLUB TUNELI)”
- “ENKEIN-OIL”
- “TIRANA THEMEL”

**KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku**

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000267 – 5

Datë: 8.4.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000267-2, datë 21.3.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Besmir Bucpapaj, me NIPT L91506016H, përfaqësues i autorizuar i subjektit Besmir Bucpapaj, prej datës 21.3.2019, ora 12:00 deri më datën 21.3.2019, ora 16:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 21.3.2019 dhe e njoftoi më datën 21.3.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", neni 32, pika 1/e,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit “Nuk ka”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 5 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim të aktivitetit deri në marrjen e masave për parandalimin e zhurmës në mjedis për të qenë brenda nivelit kufi për zonat e banuara. Gjithashtu, subjekti duhet të bëjë kalimin e lejes mjedisore të vendit ku kryhet aktiviteti në emrin e tij, ose të nisë procedurat për pajisje me leje mjedisore përkatëse për aktivitete që lëshojnë zhurma në mjedis. Një kopje e dokumentacionit për korrigjimin e këtyre shkeljeve të dërgohet pranë ISHMPUT-së Tiranë.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

19.4.2019 - Subjektit i lihet detyrë për marrjen e masave për parandalimin e zhurmës në mjedis për të qenë brenda nivelit kufi për zonat e banuara. Gjithashtu, subjekti duhet të bëjë kalimin e lejes mjedisore të



vendit ku kryhet aktiviteti në emrin e tij, ose të nisë procedurat për pajisje me leje mjedisore përkatëse për aktivitete që lëshojnë zhurma në mjedis. Një kopje e dokumentacionit për korrigjimin e këtyre shkeljeve të dërgohet pranë ISHMPUT-së Tiranë.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Besmir Stafa ID: 0301020005

*Kundër vendimit përfundimtar, subjekti **Besmir Bucpapaj** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë "Organit Epror", Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000294-5

Datë: 25.4.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000294-2, datë 3.4.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin ENKEIN-OIL, me NIPT L61703005D, përfaqësues i autorizuar i subjektit Lumturi Balla (Financiere), prej datës 2.4.2019, ora 09:00 deri më datën 2.4.2019, ora 16:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datën 3.4.2019 dhe e njoftoi më datën 3.4.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, neni 29, pika 1/b/ii,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10 448, date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, datë 14.7.2011, nenit/neneve 29, pika 1/b/ii, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Subjekti të korrigjojë shkeljet e konstatuara për zhvillimin e aktivitetit në vazhdim:

1- Të plotësojë dhe ruajë dokumentet e dorëzimit dhe transferimit të mbetjeve që gjeneron nga zhvillimi i aktivitetit, sipas VKM-ve përkatëse, të përmendura edhe në lejen mjedisore.

2- Të plotësojë regjistrin e mbetjeve sipas formatit të miratuar nga AKM-ja.

3- Të dorëzojë pranë institucioneve përkatëse informacionin apo dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të lejes mjedisore.

4- Kopje të këtij dokumentacioni të mbahet në vendin ku ushtrohet aktiviteti dhe t'i vihen në dispozicion autoriteteve kompetente në çdo moment që kërkohen për efekt inspektimi.



Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Merifa Abedini ID: 0301020031

Enver Duqi ID: 0301020002

*Kundër vendimit përfundimtar, subjekti **ENKEIN-OIL** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000157-5

Datë: 20.2.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000157-2, datë 19.2.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin TIRANA THEMEL, me NIPT K41512016I, punëdhënës z. Petrit Cullhaj (Shofer), prej datës 19.2.2019, ora 00:05 deri më datën 19.2.2019, ora 04:05.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 19.2.2019 dhe e njoftoi më datën 20.2.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, nenet 62 dhe 57,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit “Nuk ka”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 1 000 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Besmir Stafa ID: 0301020005

Ardi Pjetri ID: 0301020029

*Kundër vendimit përfundimtar, subjekti **TIRANA THEMEL** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019